REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;
- Duke e konsideruar si shumë të rëndësishëm forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale të këtij rregullatori në përmbushjen e misionit të tij, veçanërisht pas miratimit në Kuvendin e Shqipërisë të strukturës dhe organikës së re të AKEP-it;
- Duke vlerësuar që legjislacioni i ri në shërbimin postar kërkon një rregullator të fortë dhe plotësisht të pavarur që ka kompetenca të plota në rregullimin e shërbimit postar, në veçanti në dritën e liberalizimit të këtij tregu;

- Duke vlerësuar rolin e AKEP-it në nxitjen e teknologjive të reja, të cilat sjellin rritjen e konkurrencës, përmes rritjes së cilësisë, shërbimeve më të mira dhe më efiçente;
- Duke vlerësuar rolin e AKEP-it në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përmirësimit të mbrojtjes së interesave të përdoruesve;
- Duke konsideruar që një liberalizim i mëtejshëm i tregut të shërbimit postar garanton një siguri më të lartë dhe një cilësi më të mirë shërbimi për qytetarët;
- Duke vlerësuar që penetrimi i telefonisë fikse dhe brezit të gjerë vazhdon të mbetet i ulët;

Vlerëson:

- Analizën në tregun e telefonisë celulare, si dhe masat e marra në përfundim të saj, lidhur me barazimin e tarifave të operatorëve për thirrjet on net/off net si një masë, e cila do të ketë ndikim pozitiv si për sa i takon konsumatorëve ashtu edhe për sa i takon nxitjes së konkurrencës dhe rritjes së cilësisë dhe shërbimeve të ofruara nga operatorët.
- Punën e bërë në mënyrë të vazhdueshme për heqjen e barrierave administrative në procesin e lëshimit të autorizimeve individuale, përmes informatizimit të sistemit të aplikimeve për pajisjen me autorizim për frekuenca dhe për numra.
- Punën e bërë në hartimin dhe miratimin e një sërë aktesh normative rregullatore, në fushën e komunikimeve elektronike, si dhe përafrimin e tyre me legjislacionin e BE-së.
- Kryerjen e studimit mbi mënyrën dhe kushtet e përdorimit të brezave të frekuencave 900/1800, i cili ka një rëndësi të veçantë për vijimin e procedurave ligjore në implementimin e teknologjisë 4G në vendin tonë.
- Bashkëpunimin me Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për mbylljen e faqeve të internetit, të cilat kanë në përmbajtje lojëra fati online.
- Bashkëpunimin e AKEP-it me Ministrin për Inovacionin dhe Administratës Publike për hartimin e projektligjit për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë.
- Punën e bërë për mbylljen e kontratave "kolektive" dhe regjistrimin e tyre me kontrata individuale.
- Punën e bërë në plotësimin e objektivave rregullatore, për nxitjen e zhvillimit të sektorit postar.
- Përpjekjet për krijimin e kushteve për zbatimin dhe zhvillimin e teknologjive të reja në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nxitjes së përdorimit racional dhe efiçent të burimeve të kufizuara (frekuencave dhe numeracionit).

Rekomandon për vitin 2015:

- Forcimin e rolit të AKEP-it në mbrojtjen e konsumatorit (përdoruesve) në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare, për të garantuar mbrojtjen e interesave të përdoruesit në aspektin individual, mbrojtjen e interesave të përdoruesve në tërësi nga sjelljet diskriminuese dhe antikonkurruese të

operatorëve në tregun e komunikimeve elektronike, trajtim të barabarte dhe jodiskriminues të të gjithë përdoruesve, si dhe një monitorim dhe kontroll të shërbimeve që i ofrohen përdoruesve.

- Të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme tregun e komunikimeve elektronike, me qëllim uljen e tarifave të tregut.
- Të mbajë në mbikëqyrje të vazhdueshme situatën në tregun komunikimeve elektronike dhe postare, në veçanti atë të telefonisë celulare, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë detyrimeve të vendosura pas përfundimit të analizës së tregut të telefonisë celulare, për të garantuar trajtim të barabartë, si dhe konkurrencë të ndershme dhe jodiskriminuese në mbarëvajtjen e tij.
- Të intensifikojë bashkëpunimin me institucionet, veprimtaria e të cilave është e lidhur dhe ndikon në çështje që kanë të bëjnë me tregun e komunikimeve elektronike dhe postare, në mënyrë të veçantë me Autoritetin e Konkurrencës, në kuadër të efektit që kanë në tregun e telefonisë celulare vendimet e marra nga AKEP-i pas rekomandimeve të AK-së dhe përfundimit të analizës së këtij tregu nga AKEP-i.
- Me miratimin e projektligjit për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë në Kuvend, të marrë masat e nevojshme për përgatitjen e kuadrit rregullator për shërbimin postar, miratimin e akteve nënligjore, rregulloreve e metodikave të nevojshme, të cilat kërkohen në kuadër të zbatimit të tij.
- Në kuadër të ligjit të ri "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", të marrë masat e nevojshme për mbikëqyrjen e tregut dhe ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve të ofruesve të shërbimit postar të autorizuar si një detyrë e rëndësishme e organit rregullator (AKEP).
- Në kuadër të detyrave që lindin nga legjislacioni i ri i përmirësuar, të marrë masa për nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në shërbimin postar, përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit, sigurimin e ofrimit të shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve dhe sigurimin e trajtimit të barabartë të tyre.
- Të marrë masat e nevojshme për publikimin e numëratorit telefonik, si një kërkesë e shërbimit universal, si dhe shërbimet e kërkimit në numërator.
- Të rrisë përpjekjet për forcimin e profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të stafit të entit.
- Të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje, e cila, bazuar në ligjin për komunikimet elektronike, të japë disa drejtime dhe orientime për marrëdhëniet midis sipërmarrësve në rastin e shfrytëzimit të facilitetеve të përbashkëta. Kjo do të jetë një rregullore ku do bazohen palët në rastin e mosmarrëveshjeve për tarifat e infrastrukturës.
- Të bashkëpunojë me Ministrin për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe aktorët e tjerë, lidhur me situatën kabllove ajrore, në mënyrë që nga njëra anë të bëhet e mundur që brenda një afati kohor të arsyeshëm të krijohet infrastruktura e nevojshme për zhvendosjen dhe sistemimin e kabllove dhe nga ana tjetër të mbajë parasysh impaktin te konsumatorët lidhur me shërbimet e telefonisë, internetit dhe shërbime të tjera me rëndësi për qytetarët që ofrohen përmes këtij rrjeti.
- Të marrë masat e nevojshme për konsolidimin e bashkëpunimit të AKEP-it me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me monitorimin procesit të shkatërrimit të të dhënave personale të shtetasve, nga kompanitë celulare, si një detyrim që kompanive u rrjedh nga ligji i AKEP-it.
- Të ndjekë dhe të monitorojë procesin e portabilitetit të numrit, në mënyrë që nga operatorët të mos ketë vonesa të pabazuara kur përdoruesit dëshirojnë të bëjnë portimin e numrit të tyre.
- Të marrë masat e nevojshme për implementimin e projektit për krijimin e Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Frekuencave, duke zhvilluar Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave.
- Të marrë masat e nevojshme për ndjekjen e procesit të dhënies së të drejtave të përdorimit për kanalet e lira në brezin 900 MHz dhe 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX.
- Të marrë masat e nevojshme për kryerjen e analizës së tregut të telefonisë fikse.
- Të vijojë të angazhohet në zbatimin e politikave nxitëse për një penetrim më të madh të telefonisë fikse dhe të aksesit "broadband", të cilat mbeten në nivele të ulëta.
- Të vazhdojë të angazhohet në administrimin me efektivitet të spektrit të frekuencave.

- Me gjithë rritjen e numrit gjatë vitit 2014, të vijojë inspektimin e sipërmarrësve të tregut të komunikimeve elektronike dhe postare për evidentimin e rasteve të shkeljeve dhe marrjen e masave sipas legjislacionit përkatës.

- Të kontrollojë periodikisht brezat e frekuencave deri në 18 GHz dhe të monitorojë brezat e frekuencave 2,6 GHz, 2,4GHz, 5,8 GHz, si dhe të ndjekë me përgjegjshmëri problematikat që dalin nga ndërhyrjet e dëmshme (interferencat).

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 11.6.2015